

VENDIM
Nr. 235, datë 5.11.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“VOLTON” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”; dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2293/1 prot., datë 1.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Volton’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Volton” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2293 prot., datë 28.10.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”; për pikën 2.4 gjerat “a”, “b” dhe “d”.

- Për këtë aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë.

- *Pika 1.1, Formati i aplikimit:* aplikuesi duhet të depozitojë shtojcën 1 të plotësuar.

- *Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ.*

- **germa “b”:** aplikuesi duhet të depozitojë në ERE, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë dhe administratorët e saj.

- *Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal.*

- **germa “b”:** aplikuesi duhet të dokumentojë në ERE garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike për një periudhë të paktën një mujore, shoqëria “Volton” sh.p.k. duhet të sigurojë mbështetjen financiare të mjaftueshme që përkon me sasinë e parashikuar për furnizim. Shoqëria ka deklaruar që do të furnizojë 8.7 GWh (ose 8,700 MWh) gjatë vitit të parë, që ndarë për një muaj do të thotë afërsisht 725 MWh. Aktualisht, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria, është siguruar një shumë e cila nuk përmbush kërkesën për mbulimin e plotë të kostos së nevojshme. Sasia e energjisë prej 725 MWh është një sasi e konsiderueshme, dhe për të mbuluar blerjen e saj, shoqëria do të ketë nevojë për një fond që tejkalon ndjeshëm shumën e dokumentuar prej saj. Prandaj, kërkohet që shoqëria të sigurojë dhe të paraqesë dokumentacion shtesë që mbulon diferencën monetare, në mënyrë që të përmbushen plotësisht kërkesat e rregullores për mbështetje financiare të qëndrueshme. Gjithashtu, në dokumentacionin e depozituar nuk është përcaktuar qartë që shuma e dokumentuar është e dedikuar specifikisht për veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike. Për të përmbushur kërkesat e rregullores dhe për të siguruar qartësi

në dedikimin e fondeve, kërkojmë që shoqëria “Volton” sh.p.k. të paraqesë një deklaratë ose dokument tjetër që përcakton dedikimin e kësaj shume për këtë veprimtari.

- *Pika 2.4, Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike.*

- **germa “c”:** shoqëria ka përcjellë në ERE kontratën e qirasë nr. 5448 rep., nr. 1890 kol., datë 16.10.2024, të lidhur për një afat kohor prej 3 vjetësh. Neni 5, pika 1, germa “d”, e rregullores përcakton se kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës së lëshuar nga ERE për veprimtarinë e furnizimit është deri në 5 vjet, sipas kësaj kontrate të depozituar në ERE, shoqëria do të licencohet për një afat 3-vjeçar, në të kundërt duhet të depozitojë në ERE një kontratë të re qiraje me afat 5-vjeçar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Volton” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti